



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1566/5 prot

Pukë, më, 20.10.2025

VENDIM
Nr. 41 , datë 17. 10. 2025

„Për dhënien e miratimit dhe vazhdimin e procedurës së heqjes nga fondi pyjorë publik të sipërfaqjes 0.9920 ha dhe pakësimin në volum, për ndertimin e objektit agroturizem nga zhvillues Xhauri Resort&spa ,ne Ekonomine Pyjore Gomsiqe parcela 138/b ne pronesi te Bashkia Puke“ .


Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 “Për transferimin në pronesi të Bashkive të fondit pyjorë e kullësor publik.”, V.K.M-ve nr 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhenjes në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit ,procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimin e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 “Përpërcaktimin e çmimeve tarifave për dhenjen në shfrytëzim/Përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore 1374, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor” Udhezimin e Ministrisë të Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhenje në përdorim të fondit pyjorë dhe kullësor publik”, me shkresën nr.6422 prot date 04.09.2025 të Ministrisë së Turizmit, Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve për hartimin e raportit tekniko-ekonomik. Drejtoria Përgjegjëse për pyjet dhe Kullotat hartoj raportin vlerësimit tekniko-ekonomik dhe relacionin me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Keshilli bashkiak , pas shqyrtimit ;

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për vazhdimin e procedurave për heqje nga fondi pyjorë të sipërfaqjes **0.9920** ha, në ekonomine pyjore Gomsiqe, parcela nr.138/b, zona kadastrale 3070 pasuria nr.1120/1.Për ndertimin e objekteve në funksion të agroturizmit nga “Xhauri Resort &SPA”sh.p.k
2. Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave , të kryejë përditësimin e kadastrës pyjore në sipërfaqe dhe vëllim duke reflektuar ndryshimet që do të ndodhin si rrjedhojë e heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjorë publik, pas dhënies së miratimit përfundimtar.
3. Raporti tekniko-ekonomik së bashku me kopje të këtij vendimi të përcillet pranë Ministrisë së Turizmit nga Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave.

4. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.
6. Vendimi u shpall me datë **20.10.2025**.
Vota të vlefshme gjithsej 10
Vota pro 10, vota kunder 0, vota abstenim 1

SEKRETARI
Hazbi Terbuni



KRYETARI
Gjon GJOKA



06.11.25

H. i. e. S. S. S.
A. i. e. S. S. S.
pen. i. f. y.
f. y. y. y.



H. i. e. S. S. S.
A. i. e. S. S. S.
1566
06.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 674/ prot.

Shkodër, më 03.11.2025



Lënda: Mbi vendimin Nr.41 datë 17.10.2025 të Këshillit të Bashkisë Puke.

KËSHILLIT TE BASHKISE PUKË

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 germa a, neni 16, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 9 pika 1.2 , a dhe c, neni 27 pika 5, neni 55/3, neni 64 germa c, Ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet” neni 5, VKM Nr.433 date.8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 date.9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, VKM Nr.888 datë.27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” pika 2/d, kap III, materialit të derguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Pukë Nr.1781/4.prot datë. 20.10.2025 “Procesverbal i mbledhjes të Këshillit Bashkiak Pukë”, Shkresës së Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit Nr.6422.prot datë.4.09.2025 “Per pergaditjen e raportit tekniko-ekonomik per zhvillimin e agroturizmit”, **shqyrtoi VKB Pukë Nr.41 dt.17.10.2025** “Mbi propozimin per vazhdimin e procedures se heqjes nga fondi pyjor publik te siperfaqes 0.9920 ha dhe pakësimin në volum për ndërtimin e objektit agroturizëm nga zhvilluesi “Xhauri Resort & SPA”, në ekonominë pyjore Gomsiqe parcela 138/b, në pronësi te Bashkisë Pukë”.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore. Duke ju falënduar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

